



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.16, datë 31. 08. 2017

Për

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për vlerësimin e performancës së Bazës së të Dhënave Referencë të Centralizuar - CRDB të Portabilitetit të Numrit dhe për mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të CRDB”.

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 31.08. 2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për vlerësimin e performancës së Bazës së të Dhënave Referencë të Centralizuar - CRDB të Portabilitetit të Numrit dhe për mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të CRDB”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore nr.43, datë 22.09.2016 “Për Mënyrën e Zbatimit të Portabilitetit të Numrit”;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi Projektaktin “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara të portabilitetit të numrit””;
- Dokumenti për Këshillim Publik;
- Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe duke i'u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se :

1. Drejtorja e Administrimit të Frekuencave, Numeracionit dhe Autorizimeve dhe Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit Broadband me qëllim zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në aktet normative rregullatore dhe në kuadër të mbykqyrjes së procesit të bartjes së numrit dhe operatorit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit Drejtues dokumentin për këshillim publik “Për vlerësimin e performancës së Bazës së të Dhënave Referencë të Centralizuar - CRDB të Portabilitetit të Numrit dhe për mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të CRDB”;
2. Dokumenti për Këshillim Publik është hartuar për të evidentuar nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe të interesuar të tjerë nëse shërbimi i bazës së të dhënave referencë e centralizuar ofrohet mjaftueshëm, nëse operimi duhet ndryshuar ose shtuar funksionalitete dhe për mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të bazës së të dhënave referencë;
3. Dokumenti merr në konsideratë:
 - çështjet e konstatuara në funksionimin e CRDB e vecanërisht pas hyrjes në fuqi të Rregullores nr.43, datë 22.09.2016 “Për Mënyrën e Zbatimit të Portabilitetit të Numrit”
 - numrin e operatorëve të ofrimit të shërbimit të portabilitetit që janë të lidhur me CRDB si dhe;
 - kërkesat dhe sugjerimet e paraqitura nga operatorët e telefonisë fikse dhe të lëvizshme në lidhje me procesin e bartjes;
 - Dokumenti për këshillim publik i shërben qëllimit të përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që dalin kjo rregullore dhe vendimet e AKEP-it në funksion të ofrimit të shërbimit të CRDB të portabilitetit të numrit, përmirësimit, në zgjerimin e mënyrës së ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit dhe mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të bazës së të dhënave referencë.

Nga pikëpamja ligjore projektakti është përgatitur bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, ligji 9918, i ndryshuar, dhe Rregullore nr. 43, datë 22.09.2016 “Për Mënyrën e Zbatimit të Portabilitetit të Numrit”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Këshilli Drejtues, bazuar në nenin 114 dhe nenin 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 43, datë 22.09.2016 “Për Mënyrën e Zbatimit të Portabilitetit të Numrit”.

V E N D O S:

1. Të miratojë për këshillim publik dokumentin “Për vlerësimin e performancës së Bazës së të Dhënave Referencë të Centralizuar – CRDB të Portabilitetit të Numrit dhe për mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të CRDB”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Periudha e këshillimit publik do të jetë 30 ditë dhe përfundon me datë 2 Tetor 2017.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____